



**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMINË MES TË  
UNIVERSITETIT “UKSHIN HOTI” NË PRIZREN  
DHE  
FAKULTETIT TË EKONOMISË DHE AGROBIZNESIT -  
UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS**

Bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet Universitetit Bujqësor të Tiranës dhe Universitetit “Ukshin Hoti” i Prizrenit Nr. Prot. 1016 datë 20/06/2013, firmosur nga rektorët e dy Universiteteve, hartohet marrëveshja teknike si më poshtë:

Marrëveshje teknike bashkëpunimi që lidhet mes Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren i përfaqësuar nga Rektori Prof. Dr. Ramë Vataj dhe Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit të Universitetit Bujqësor të Tiranës i përfaqësuar nga Dekani Prof. Dr. Bahri Musabelliu. Marrëveshja realizohet me qëllim të funksionalizimit të njesisë së re akademike në kuadër të UPz të quajtur Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit, që në tekstin e mëposhtëm të kësaj marrëveshje do të përdoret shprehja Fakulteti.

Palët bien dakord që të respektojnë dispozitat e kësaj marrëveshje të shprehura më poshtë.

Neni 1

Të dy Fakultetet do të shkëmbejnë personel akademik për të zhvilluar leksione, për të udhëhequr sipas nevojës kandidatë në punimet e diplomave, për të kryer kërkime shkencore, shkëmbim përvoje si dhe për të marrë pjesë në projekte shkencore e profesionale me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar.

#### Neni 2

Të dy Fakultet, do të shkëmbejnë së paku një herë në vit studentët e nivelit baçelor të programit studimor Agrobiznes, për forcimin dhe avancimin e aktiviteteve mësimore-edukative, si dhe në rast nevojë për njërën palë të bëhen dhe ushtrimet laboratorike, përvojë praktike, etj.

#### Neni 3

Të dy Fakultet, në mënyrë të përhershme do të shkëmbejnë: planprograme mësimore, informata shkencore, dokumentacione dhe publikime shkencore si dhe do të diskutojnë për çështje të përgjithshme ose të veçanta për avancimin e punës dhe reformës të fakulteteve.

#### Neni 4

Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit do të ndihmojë në kualifikimin e personelit akademik nga fushat përkatëse sipas nevojës e marrëveshjes së veçantë me Fakultetin e Shkencave të Jetës dhe Mjedisit, duke pasur parasysh dispozitat në fuqi.

#### Neni 5

Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit do të ndihmojë me personel akademik Fakultetin e Shkencave të Jetës dhe Mjedisit për fushat specifike sipas nevojave dhe kërkesave të tij. Personeli akademik caktohet nga ana e deleguesit.

#### Neni 6

Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit do të ndihmojnë Fakultetin e Shkencave të Jetës dhe Mjedisit në sigurimin e literaturës shkencore e profesionale nga botimet e veta ose me literaturë tjetër.

#### Neni 7

Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit do të ofrojë në dispozicion të gjitha hapësirat dhe kapacitet e tij për mbulimin e mësimin nga pjesa praktike apo eksperimentale për studentët e Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit për fazat e para gjatë konsolidimit të tij.

#### Neni 8

Të dy Fakultetet, bien dakord që të formojnë një Komision për hartimin e planprogrameve studimore në kuadër të Fakultetin e Shkencave të Jetës dhe Mjedisit.

Neni 9

Të dy palët me konsensus reciprok mund të bëjnë amendamente në këtë marrëveshje ose të shtojnë ndonjë aneks. Në qoftë se ndonjëra palë heq dorë nga kjo marrëveshje, është e obliguar që të informojë me shkrim palën tjetër të paktën tre muaj përpara.

Neni 10

Kjo marrëveshje është përpiluar dhe e nënshkruar në gjuhën shqipe në katër kopje nga dy për secilën palë dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga përfaqësuesit e autorizuar të institucioneve.

Më: 15/06/2015

Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren

Rektori

Prof. Dr. Ramë Vataj



Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit

Universiteti Bujqësor i Tiranës

Dekani

Prof. Dr. Bahri Musabelliu

